

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Blushi te Ligjet: Sot në konsultë, subjekte të filmave të Gysit. Harta e PS si tenderat e paracaktuar të Ra mës e Ballukut
ADRESA	https://piranjat.al/politike/blushi-te-ligjet-sot-ne-konsulte-subjekte-te-filmave-te-gys-it-harta-e-p-i106401
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 10:57:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 10:48:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4272427cbdf2b96d2697e28c1b437931d37c816ffe7afb4eefd424a52c95e3a2
TEKSTI	7cfe7c3eb8401b017e90aa1a321fcd388221640f18f112bd45941b85f2adc94f
PAMJA	87c1598d1ef734a624ec1adf2b3234ce3272699c120d618a74e7aff62385e959

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2ef337f40879930133886d738c34346e6c89aea170ca5f65e9936eb3bad611ca
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b4355a68894c65a63b1e90d1f962746a91a9c18b00f6b0772c3894db0f3539f0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/2ef337f40879930133886d738c34346e6c89aea170ca5f65e9936eb3bad611ca

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **Gysit. Harta e PS si** ■ **in dhe Vlorë** ■ **publikojnë** ■ **negociatave** ■ **Sanpaoio-n,** ■ **95 milionë** ■ **turpshe**
ne Komisionin e Ligjeve ■ kryeministrin Edi Rama për mungesë ■ "Homeland Justice" të ■ integritit evropian të Shqipërisë ■ euro në ■ sigurisë

[POLITIKE](#)

Blushi te Ligjet: Sot në konsultë, subjekte të filmave të Gysit. Harta e PS si tenderat e paracaktuar të Ramës e Balllukut

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 12:48



Kreu i grupit parlamentar të PL-së, Tedi Blushi kundërshtoi në Komisionin e Ligjeve projektin e PS-së për reformën territoriale. Ai e cilësoi antikushtetues dhe të ngjashëm me tenderët e paracaktuar të Ramës dhe Balllukut.

Ai kritikoi mungesën e konsultimeve me banorët e bashkive që preken dhe ngriti pikëpyetje për kriteret e përzgjedhjes së tyre, duke thënë se vendimi është i motivuar politikisht. Blushi kërkoi që procesi të ndalet dhe të merret në shqyrtim edhe propozimi i opozitës për një ndarje të re administrative.

Fjala e tij:

Unë dua t'ju kujtoj faktin që në qoftë se ka një Komision përgjegjës për respektimin me rigorozitet të Kushtetutës, është pikërisht Komisioni i Ligjeve.

Ndaj dua t'ju kujtoj që avancimi i një procesi antikushtetues nga Komisioni i Ligjeve, që është garanti për mbrojtjen e Kushtetutës, nuk mund të vijojë.

Shoh që keni thirrur sot për konsultim edhe subjekte apo aktorë të firmave të Gysit apo aleatë me bandat në pushtetin lokal edhe kjo është zgjedhja juaj.

Megjithatë, meqenëse kolegja Bylykbashi ka marrë përsipër të mbrojë një akt thellësisht antikushtetues, dua ta pyes, kur bëtë fushatë në Cërrik dhe në Belësh, a u premtuat që do ju shkrini bashkinë?

Sikundër kam një pyetje për Z. Komici që banorët e Prrenjasit e nxorrën nga takimi.

Ju drejtova Znj. Bylykbashi meqenëse është dhe nismëtare e këtij projektligji dhe meqenëse ka bërë fushatë dhe në Cërrik dhe në Belësh. Këtyre banorëve të këtyre bashkive që ju propozoni të shkrini, a u premtuat që do u shkrinit bashkitë?

Sepse e kemi parë Z. Komici që e kanë dëbuar nga mbledhja banorët e Prrenjasit.

Po sjell shembuj konkretë të konsultimeve publike që ju keni bërë në terren si mazhorancë.

Shoh në këtë mbledhje që është i pranishëm kryetari i bashkisë së Fushë-Arrëzit, kur është zhvilluar konsultimi në këtë bashki? Nuk ka patur kurrë konsultime në këtë bashki.

Ndaj për të përfunduar qëndrimin tim, është për të ardhur keq që ndërkohë që ndërkohë që keni një tjetër propozim në tavolinën tuaj edhe në sirtarët e Kuvendit të Shqipërisë, që është propozimi i opozitës së bashkuar për një tjetër ndarje të re Administrative, do ju kërkoja në respekt të rregullores që buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të mos avanconi me një projekt që i përngjason tenderave të paracaktuar të Edi Ramës dhe Belinda Ballukut.

Se jam i bindur se në qoftë se sot Rony Yeffet do jetonte në Fushë-Arrëz , do e kishit lënë bashki më vete.

Sikundër jam i bindur se në qoftë se Gysi do jetonte në Memaliaj, sigurisht që edhe Memaliajt do i kishit dhënë statusin special.

Ndaj, ta ndërpresim këtë proces dhe në qoftë se nuk doni ta ndërprisni këtë proces për të marrë në vlerësim edhe një tjetër propozim të opozitës, atëherë më vjen keq po, po më ngjasoni të gjithë me Vlora Hysenin, doni ti fikni radarët të 15 bashkive, port ë jeni të sigurt që nuk mund të lejojmë ti fikni radarët për 15 bashki, të cilat as nuk i keni pyetur, përkundrazi janë ngritur në revoltë.

Sot, banorët e Policanit, socialistë të Policanit, të Maliqit, të Memaliajt po ngrohen me tesarat e Partisë Socialiste.

Ndaj dëgjoni thirrjen e tyre dhe mos avanconi, pra këtu është procedura, mos avanconi me një proces thellësisht antikushetues.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 28 Shtator12:35

[“Alibia e Ramës ka rënë”, Bardhi: Të japë llogari për SHISH-in dhe Vlora Hysenin, përgjegjësia politike është e ti](#)

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka akuzuar kryeministrin Edi Rama për mungesë llogaridhënieje dhe p...

POLITIKE 28 Shtator11:50

[Ambasadorja e BE ‘shuplakë’ Ramës: Ambicia për mbylljen e negociatave deri në 2027 kërkon reforma](#)

Ambasadorja e BE në Tiranë, Sofia Moreira se la Sousa ka vënë theksin te procesi i integrimit evropian të Shqipërisë dhe ve...

POLITIKE 28 Shtator10:01

[Këshilli i Sigurisë në mbledhje, PD: Shkaktarët s’mund të jenë shpëtimtarë, kërkohet qeveri teknike](#)

Partia Demokratike thotë se mbledhja e sotme e Këshillit të Sigurisë lidhur me zhvillimet e fundit në vend pas arrestit të ish-k...

POLITIKE 28 Shtator09:39

["Grekët e maqedonasit e gjetën gjuhën, ndërsa ne jo!"/ Fjalimi i Ditmir Bushatit 7 vite më parë në Parlament: Pasuria është grumbulluar në një rreth vicioz njerëzish](#)

Në atë kohë, Bushati e cilësonte Shqipërinë në një “udhëkryq të madh” dhe ngrinte një pyetje ...

POLITIKE 28 Shtator09:28

[Prenci: Vlora Hyseni nuk shkoi në takimin e Bakusë, nuk iu sekuestruan telefonat](#)

Teksa Presidenti i Republikës, Bajram Begaj ka thirrur mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare për skandalin e SHISH, të...

POLITIKE 28 Shtator09:17

[Skandali i SHISH-Asnjë ftesë për opozitën/ Këshilli i Sigurisë Kombëtare vetëm me të 'besuarit' e Ramës](#)

Mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, e thirrur nga Presidenti Bajram Begaj në Pallatin e Brigadave, rikthen në vëmën...

POLITIKE 28 Shtator08:58

[Mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, kryeministri Rama mbërrin në Pallatin e Brigadave](#)

Kryeministri i vendit, Edi Rama ka mbërritur në Pallatin e Brigadave, aty ku do të mbledhet Këshilli i Sigurisë kombëtare. Kjo m...

POLITIKE 28 Shtator07:46

[Sot dita e 121-të e protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë: Rama, jep dorëheqjen!](#)

Qytetarët do të mbledhen sot në protestën e 121-të radhazi kundër qeverisë Rama. Për më shumë se tre muaj, q...

POLITIKE 27 Shtator22:26

[Mbyllet protesta e 120-të kundër Edi Ramës/ Qytetarët nuk ndalen: Nesër më shumë](#)

Është mbyllur protesta e 120-të kundër qeverisë së Edi Ramës, pas disa orësh tubim dhe marshim në rrugët e Tir...

POLITIKE 27 Shtator21:48

[Skandali me SHISH dhe aforat e qeverisë: protestuesit macezh Ramës në bulvardin para Kryeministria: Krimi ka kokë!](#)

Në ditën e 120-të të protestave qytetare kundër qeverisë, protestuesit i kanë përcjellë një tjetër mesazh...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 27 Shtator

[I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elba...](#)

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku ...

AKTUALITET 27 Shtator

[“Je rrezik për sigurinë kombëtare”, Azgan Hakla...](#)

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Azgan Haklaj, është ndaluar nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut në pikën kufitare të...

BOTA 27 Shtator

[“Kam vrarë vetëm 9”/ Njihuni me ‘engjëllin e vd...](#)

Ajo është infermierja vrasëse që u bë famëkeqe shumë kohë përpara se Lucy Letby të dënohej me burg. Bever...

INVESTIGIME 26 Shtator 13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.